



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

KORNIZA AFATMESE BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË GJAKOVËS 2015-2017

2014

DEKLARATË E QEVERISË KOMUNALE PËR KORNIZËN AFATMESME TË SHPENZIMEVE 2015 - 2017

KORNIZA E PËRGJITHSHME

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017 si dokument i rëndësishëm dhe më kryesor paraqet koherencën, koordinimin dhe ndërlidhjen funksionale në mes të prioritetëve të përcaktuara me dokumentet strategjike komunale për zhvillim në njërin anë si dhe përfshirjen e tyre konkrete e specifike në projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme. Duke u bazuar në këto premisa themelore që përfshijnë aspektet e menaxhimit të financave publike, ato fiskale, ekonomike e shoqërore është konceptuar edhe Deklarata e Prioritetëve të Qeverisë komunale konform Strategjisë komunale për zhvillim. Planit zhvillimor komunal dhe atij urban dhe dokumenteve tjerë komunal për KASH-in 2015-2017.

Prioritetet e Qeverisë Komunale të Gjakovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në nivel të Republikës së Kosovës 2015-2017, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, infrastrukturën komunale, sektorin e arsimit, kulturës, rinisë dhe sporteve, sektorin e shëndetësisë primare, atë të bujqësisë, mjedisit etj. Prioritetet afatmesme 2015-2017, bazohen në Programin e Punës së Qeverisë Komunale dhe prioritetet e saj për një zhvillim të gjithanshëm ekonomik të komunës konform mundësive dhe limiteve buxhetore që na përcakton KASH-i për këtë periudhë.

Në procesin e realizimit të prioritetëve të Qeverisë Komunale rëndësi e veçantë i kushtohet qëndrueshmërisë buxhetore dhe projeksioneve makro-fiskale për periudhën afatmesme. Në këtë drejtim do të punohet që të vazhdohet me ritmin e ngritjes së vazhdueshme të investimeve kapitale, pastaj të ruhet stabiliteti buxhetor, ngarkesa e ultë e biznesit me tatime si dhe rritja e nivelit të grumbullimit të të hyrave vetanake.

Duke u bazuar në rolin e madh që ka në zhvillimin ekonomik Qeveria e komunës ka investuar në vazhdimësi në përmirësimin e infrastrukturës si bazë e domosdoshme për një zhvillim të përgjithshëm të komunës.

Prioritetet e Qeverisë komunale janë të përmbledhura në katër shtyllat e mëposhtme;

- Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- krijimin e kushteve të një klime konkurruese për zhvillim lokal
- Zhvillimi i resurseve njerëzore;
- Rritja e standardit jetësor dhe mirëqenës sociale për banorët e Komunës së Gjakovës

Për të realizuar këto prioritetet Qeveria do të vazhdojë të financoj brenda kornizës buxhetore 2015-2017, në sektorët: infrastrukturë publike, bujqësi, arsim, kulturë, rini dhe sport, shëndetësi e mirëqenie sociale. Në këtë drejtim Qeveria në kuadër të ndarjeve buxhetore do të vazhdojë të mbajë nivel të lartë të investimeve kapitale të cilat do të jenë në mesataren e dy viteve të fundit.

Të gjitha prioritetet e lartpërmendura do të financohen duke ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makro-fiskale. Duke synuar rritjen e vazhdueshme të efektivitetit dhe efikasitetit si dhe përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në menaxhimin e financave publike,

Qeveria ka përcaktuar prioritetet për financim. Këto prioritate më tutje do të zhvillohen në objektivat specifike dhe të matshme brenda sektorëve përmes procesit të KASH-it. Objektivat e përcaktuara në KASH do të zhvillohen në aktivitete dhe projekte konkrete përmes procesit të rregullt buxhetor.

Sa i përket nivelit komunal është vazhduar me decentralizimin e funksioneve të caktuara dhe kështu tanimë Komunitetët kanë fleksibilitet të plotë në orientimin e shfrytëzimit të të hyrave vetanake dhe jemi të bindur se do të shërbej si stimulim në rritjen e mëtutjeshme të shkallës së arkëtimit të të hyrave vetanake komunale.

Gjithashtu vëmendje të veçantë në nivelin komunal do ti kushtohet edhe bashkërendimit të punës në mes të dy niveleve në mënyrë që koncepti zhvillimor për planifikimin shumëvjeçar të investimeve kapitale nga komunitetët të shërbejë si parametër në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të komunikimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij komunal gjatë procesit të rregullt buxhetor. Kjo do të arrihet duke përfshirë ministrinë përkatëse të linjës dhe donatorët potencial në konceptin e financimit dhe bashkëfinancimit të projekteve kapitale nëpër komunitetët e vendit.

Pra Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KASH-i, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritar, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunitetit, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale konform KASH-it të lëshuar në nivel të Republikës së Kosovës –MEF-i me 29 Prill 2014.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), paraqet një mjet në procesin e zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunitetit, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetet të tanishme dhe afatmesme të Gjakovës si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunitetit do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2015 – 2017.

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetet të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2015 - 2017.

Misioni

Misioni i Qeverisë komunale për periudhën afatmesme buxhetore 2015-2017, është përsheptimi i ritmeve të zhvillimit ekonomik, shtimin e mundësive për shkollim, përkujdesje më të madhe për shëndetin, kulturën rininë dhe sportin, lëmin e bujqësisë si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe infrastrukturës komunale, partneriteti publiko-privat si çështje më kryesore që mund të ndikojnë për përmirësimin e shpejt të gjendjes ekonomike e shoqërore të banorëve të komunitetit.

Objektivat

Prioritetet e Komunës janë që nëpërmes Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Buxhetore 2015 – 2017 synohet të arrihen këto objektiva:

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe të bizneseve,
- Përmirësimi në standardet e arsimimit dhe nivelit të arritjes ,
- Aktivizimi i potencialeve prodhuese ekonomike,
- Asistenca sociale për familjet pa të ardhura/të ardhura të ulëta .

2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Rritja e numrit të kopshteve për fëmijë,
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore ,
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë .

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi të infrastrukturës, transportit, nxehjes qendrore, dhe ofrimit të ujit,
- Përmirësimi i standardeve të ambientale,
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara.

4. Të bëhet Komuna vend më i sigurve dhe i drejtë/ fer për qytetarët e saj

Ofrimi i sigurisë në Komunë për qytetarët të cilët mund të punojnë dhe shijojnë të mirat e vendit:

- Përmirësimi i sigurisë në qytet ,
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-etnik.

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

5. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve duke u fokusuar në qytetarët si klientë, përmes krijimit të një administrate të trajnuar mirë dhe me performancë të lartë:

- Inicimi dhe zhvillimi gradual i një kornize të performancës për Drejtoritë e Qeverisë Komunale.

Pesë prioritet strategjike të komunës për periudhën afatmesme 2015-2017 do të shoqërohen me një mikës të hyrash dhe shpenzimesh kapitale të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

I. Parimet e përgjithshme për zhvillim:

Zhvillim i planifikuar hapësinor	Çdo zhvillim i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i mbështetur me vendime përkatëse
Zhvillimi i baraspeshuar	Për aq sa është e mundur, territori i Komunës së Gjakovës duhet zhvilluar në mënyrë të baraspeshuar
Zhvillimi kompakt	Në të mirë të shfrytëzimit sa më racional të hapësirës dhe mbrojtjes së resurseve duhet synuar zhvillim sa më kompakt në hapësirë, më të fokusuar dhe dendësi më të madhe të zënies së hapësirës
Zhvillimi i qëndrueshëm	Synon shkallën sa më të lartë të bilancit në mes të zhvillimit social, ekonomik dhe mjedisor
Stimulimi i si energji dhe shmangie nga konfliktet potenciale	Parim për të shfrytëzuar në mënyrën më të mirë tendencat zhvillimore të sektorëve të ndryshëm dhe autoritetet (komunat fqinje, niveli qendror etj.)
Subsidiariteti	Komuna gjatë zbatimit të PZHK, do të marr përsipër përgjegjësi apo ndërmarr veprime në raste ku ato më mirë mund të realizohen në nivelin lokal
Integrimi në Evropë	Çdo zhvillim i udhëzuar me Plan duhet për aq sa është e mundur të kontribuoj në procesin e integritetit të Kosovës në BE.
Zhvillimi komplementar	Funksioni themelor i një vendbanimi i plotëson funksionet e vendbanimit tjetër

II. Korniza Fiskale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2015-2017 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

1. Financimi komunal për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitet 2016-2017, si pjesë integrale e KAB-it 2015-2017

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) parimisht ofron deklarin e prioriteteve strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale dhe prezanton total grandet qeveritare për financimin e komunave për vitin fiskal 2015 si dhe parashikimin afatmesëm 2016-2017 si pjesë integrale e KASH-it 2015-2017.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e grave qeveritare për financimin e komunave për vitin 2015, si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Komuna e Gjakovës do të ketë në fokus të vazhdueshëm edhe parashikimin dhe Buxhetimin e Përgjithshëm Gjikor (BPGj), dhe atë sipas praktikave më të mira, të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në mënyrë që të kontribuohet në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit të financave publike duke bërë të dukshëm efektet e shpenzimeve publike.

Përcaktimi i shumave agregate të grave qeveritare dhe alokimi i tyre në komunat individuale në periudhën afatmesme të bazuar nga propozim-grandet specifike nga ministritë e linjës MASHT, MSH, MAPL dhe MPMS, është shqyrtuar dhe aprovuar në parim nga anëtarët e Komisionit të Grave sipas LFPL, dhe sipas vendimit të Zëvendësministrit të Financave me datë 22 prill 2014, duke marrë për bazë aspektet në vijim:

- Respektimi dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në LFPL
- Analizat e standardeve sektoriale të ofruara nga ministritë përgjegjëse
- Formulat shtetërore për arsimin para universitar dhe shëndetësinë primare, për alokimin e grave specifike në arsim dhe shëndetësi
- Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në kuadër të prioriteteve qeveritare.

Komunat, nga viti në vit kanë pasur një shkallë të rritur të decentralizimit fiskal dhe transparencës.

Sistemi aktual i financave komunale përbën decentralizimin fiskal të avancuar, komunat kanë kompetenca të konsiderueshme për shpenzimet, kompetenca për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin e financave publike.

Përkushtimi i përgjithshëm për të përmirësuar elementet kyçe të procesit të zhvillimit të buxhetit, ka kërkuar edhe disa ndryshime në formatin e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi mbështetur në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor:

- Shfrytëzimi i Buxhetimit në nivel të programit dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të regjistrit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e Buxhetimit të orientuar drejt rezultateve; dhe

- Zbatimi i konceptit mbi planifikimin shumëvjeçar të buxhetit/kapitaleve dhe prezantimi i të gjitha zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.

Futja në përdorim e Buxhetimit kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për rezultatet e planifikuara në sistemin e PIP-it. Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe objektivat, përfundimet dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes procesit buxhetor.

2. Propozimi i buxhetit komunal për vitin 2015-2017

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimin të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2015 do të planifikohet dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

3. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2015-2017

Financimi komunal përfshinë: grandet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grandet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grandet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në draft LMFP të akorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Komunat pranojnë Grande Operative nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe ato janë: Grandi i përgjithshëm, Grandi specifik për Arsim dhe Grandi specifik për Shëndetësi, përfshirë financimin për shëndetësi sekondare. Grandet bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive, duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e tyre.

3.1. Grandi i përgjithshëm

Komunat do të pranojnë Grandin e përgjithshëm, i cili është grand i sistemit të mbyllur dhe do ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me kuadrin ligjor.

Grandi i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është mjet adekuat për vendosjen e barazive ndërmjet komunave, dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Shuma e Grandit të përgjithshëm është dhjetë për qind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushallë) prej 140,000 €, minus 1 € për kokë banori, ose 0 € për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë.

Indikatorët që janë përdorur për alokimin e grandit të përgjithshëm në komuna janë: Numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë për qind (89%); përmasat gjeografike të komunës me gjashtë për qind (6%); numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy për qind (2%).

Grandi i Përgjithshëm për vitin 2015 është aprovuar nga Komisioni i Grandeve me datë 22 prill 2014 në pajtim me parimet, kriteret dhe formulat e përcaktuara në LFPL .

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përmes memorandumeve të mirëkuptimit, është përfshirë në kuadër të grandit të përgjithshëm të komunës. Bazuar në rekomandimet e FMN-së për shërbimet sociale, MPMS ka përgatitur propozimet e kostove për njësi për vlerësimin e shpenzimeve përkatëse.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar dhe shëndetësi primare, në pajtim me parimet dhe kriteret e përcaktuara në LFPL, duhet të financohen nga Grandi i Përgjithshëm në komuna.

3.2. Grandi specifik për Arsim para universitar për vitin 2015

Grandi Specifik për Arsim bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit sipas LFPL, duke marrë parasysh kriteret dhe parametrat në formulë si dhe politikat e arsimit para universitar nga MASHT.

Grandi specifik për Arsim para universitar për vitin 2015 është aprovuar nga Komisioni i Grandeve i lartcekur sipas propozimit të MASHT.

Financimi i grandit të arsimit i përcaktuar nga Komisioni i Grandeve për periudhën e KASH-it, synon të mbështesë objektivat e MASHT-it për arsimin para universitar.

Formula shtetërore e arsimit trajton në veçanti nivelin e shkollave para fillorë, fillore dhe të mesme. Pra, fokusi i shkollave profesionale, shkollat në viset malore, ngritjen e mësimdhënësve në karrierë, zhvillimin profesional të mësimdhënësve apo trajnimet pa shkëputje nga puna, personelin bazë për shkollat e reja, reformën e financimit në nivel të shkollës dhe arsimit me nevoja speciale i transferuar nga niveli qendror/MASHT në nivelin komunal për vitin 2015.

Formula shtetërore e arsimit nuk trajton: shkollat speciale dhe investimet e mëdha kapitale.

Formula e financimit për grandin e arsimit është si në vijim:

Alokimi komunal = Pagat për mësimdhënës + Pagat për personel administrativ dhe ndihmës + Mallrat dhe Shërbimet + Kapitalet e vogla + Politikat arsimore.

Implikimet bazë për kalkulimin e grandit të arsimit para universitar nga MASHT janë:

- a. Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2013/2014;
- b. Pagat e mësimdhënësve sipas listës së pagave dhe mesatarja e pagës që duhet të përfshirë rritjen nga licencimi dhe kostoja për rritjen e pagave prej 25% sipas Vendimit të Qeverisë Nr.01/176, datë 10.03.2014;
- c. Mallrat dhe shërbimet sipas nxënësve me parametrat e njëjtë;
- d. Përpjesëtimi nxënës-mësimdhënës i njëjtë për nivelin fillor dhe të mesëm, përjashtuar shkollat profesionale (raporti për komunitetin shumicë 1:21.3 dhe për komunitetin pakicë 1:14.2).

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr.2015/01, për Komuna, të lëshuar nga ana e MEF-it, me datë 15 Maj 2014, për Arsimin para universitar të Komunës së Gjakovës, për vitin 2015 është paraparë Grandi në shumë prej 7.004.055 €.

3.3 Grandi specifik për Shëndetësi primare për vitin 2015

Grandi specifik për Shëndetësi dhe përcaktimi i shumës së këtij grandit bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit në përputhje me LFPL.

MSH ka propozuar grandin specifik për shëndetësi primare për vitin 2014 për komuna të bazuar në formulën për kokë banori- numrit të vizitave shëndetësore X kostoja mesatare për vizitë, dhe numrit të shërbimeve X kostoja mesatare për shërbime.

Propozim-grandit specifik për shëndetësi primare për vitin 2015 nga MSH, është bazuar në formulën për kokë banori – numrit të vizitave shëndetësore x kostoja mesatare për vizitë, dhe numrit të shërbimeve X kostoja mesatare për shërbime.

Kriteret e aprovuara nga Komisioni i Grandeve janë, si vijon:

- 2.5 vizita për kokë banori me një kosto prej 4 € për një vizitë, dhe
- 3.5 shërbime për kokë banori me një kosto prej 3.9 € për një shërbim.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr. 2015/01, për Komuna, të lëshuar nga ana e MEF-it, me datë 15 Maj 2014, për Shëndetësinë primare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2015 është paraparë Grandi në shumë prej 2.235.588,00 €.

4. Perspektiva e politikave fiskale


Sipas KASH-it të Republikës së Kosovës dhe Qarkores së parë buxhetore nr.2015/01 për Komuna të 15.05.2014 dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011 , komuna e Gjakovës ka 94.556 banorë, dhe nga Komisioni i Grandeve – MEF-I për vitin 2015 Komunës sonë iu është ndarë për vitin 2015

,buxhet në shumë prej 19.753.882,00 €, apo për + 1.124.842,00 € (+ 6%) më e lartë se për vitin 2014 , i cili buxhet përbënë shumën prej 18.629.040,00 €.

Buxheti i caktuar për vitin 2015, është më i madh se për vitin 2014 (aktual) edhe si rezultat i rritjes së pagave prej +25%, nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili është aplikuar që nga muaji Prill/2014.

Tabela nr. 1. Krahاسimi i Buxhetit 2014/2015

Nr.	Buxheti komunal	Shuma e Buxhetit	%-Përqindja
	Buxheti - 2014 (Aktual)	18.629.040	
	Buxheti - 2015	19.753.882	
	Ndryshimi	1.124.842	+6%



**TABELA KRAHASUESE E FINANSIMIT TË BUXHETIT TË KOMUNËS SË
GJAKOVËS 2014/2015 (Aktuale)**

Sipas Qarkores se parë buxhetore nr.2015/01, për Komuna , të datës 15.05.2014, të lëshuar nga ana e MF, për periudhën 2015-2017, Komunës së Gjakovës iu është caktuar buxheti për financimin e shpenzimeve 3 vjeçare sipas këtyre burimeve, siç shihet edhe në tabelën numër 3 në vijim:

Tabela nr.2 - Totali i financimit komunal për vitet: 2015-2017

Burimet e financimit		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Granti i Përgjithshëm	7,487,928.00	7,479,025.00	7,602,086.00
2	Granti specifik i Arsimit	7,004,055.00	7,073,932.00	7,107,956.00
3	Granti specifik i Shëndetësisë	2,235,588.00	2,333,062.00	2,386,183.00
4	Të hyrat vetanake komunale	3,026,311.00	2,977,911.00	3,035,911.00
Totali:		19,753,882.00	19,863,930.00	20,132,136.00

Natyrisht se Kërkesat buxhetore për periudhën 2015-2017 nga ana e Drejtorive komunale janë shumë më të mëdha se sa limitet e përcaktuara me Qarkoret buxhetore të lëshuara nga ana e MF-ës.

4.1 Parashikimi i të hyrave komunale.

Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores Mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Të hyrat realizohen nëpërmes Drejtorive komunale të cilat participojnë në krijimin e të hyrave vetanake të komunës .

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Me kërkesën e MF-ve, Komuna e Gjakovës ka paraqitur pranë kësaj Ministrie me datë 21.03.2014, Propozim Planin e të hyrave vetanake komunale për vitin 2015 në shumë prej 2.772.500,00 €, por MF –ve, me Qarkoren buxhetore nr. 2015/01, për Komuna , ka përcaktuar për komunën e Gjakovës Planin e të hyrave vetanake në shumë prej 3.026.311,00 €, çka do të thotë së ky plan është më të madh për 253.811,00 €, se sa plani i paraqitur nga ana e jonë, sepse mendojmë që ky plan është i lartë dhe vështirë i realizueshëm.

Tabela nr.3 – Të hyrat vetanake komunale 2015-2017 sipas programeve buxhetore.

PLANI I TË HYRAVE VETANAKE PËR PERIUDHËN ; 2015, 2016 dhe 2017, SIPAS DREJTORIVE				
Kodet	BURIMET E TË ARDHURAVE	Vlerësimi 2015	Vlerësimi 2016	Vlerësimi 2017
1	Drejtoria e Urbanizmit	326,000.00	359,000.00	394,000.00
50009	Lejet e ndërtimit-(Taksa administrative dhe Tarifa rregullatorë për rritjen e densitetit)	255,000.00	281,000.00	309,000.00
50011	Taksa urbanistike te ndryshme	24,000.00	27,000.00	29,000.00
50405	Kompensimi për shfrytëzimin e hapësirës publike	32,000.00	35,000.00	39,000.00
50408	Qiraja e objekteve të banimit social	15,000.00	16,000.00	17,000.00
2	Drejtoria e Shërbimeve Publike	33,000.00	35,400.00	37,700.00
50103	Sekuestrimi I automjeteve	3,000.00	3,200.00	3,400.00
50008	Të hyrat nga parkingjet	10,000.00	10,500.00	11,000.00
50005	Taksa për leje vozitje - autobusëve	5,000.00	5,500.00	5,800.00
50406	Të hyrat nga tregjet	12,000.00	13,000.00	14,000.00
50401	Shërbimet tjera,	3,000.00	3,200.00	3,500.00
3	Drejtoria e Inspeksionit	63,000.00	66,000.00	70,000.00
50505	Dënimet nga Inspeksioni	18,000.00	19,000.00	21,000.00
50507	Inspektimi higjenik sanitar	25,000.00	26,000.00	27,000.00
50211	Taksa për shërbimin e pijeve alkoolike	20,000.00	21,000.00	22,000.00
4	Drejtoria e Agrikulturës	20,000.00	22,000.00	24,000.00
50012	Shndërrimi I tokës bujqësore në jo-bujqësore	15,000.00	16,000.00	17,000.00
	Të hyrat nga pylltaria	5,000.00	6,000.00	7,000.00
5	Kadastra	94,500.00	103,000.00	109,000.00
50504	Të hyrat nga shërbimet kadastrave	92,000.00	100,000.00	105,000.00
50503	Të hyrat nga Ekspertiza	2,500.00	3,000.00	4,000.00
6	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik			

		288,000.00	291,000.00	294,000.00
50204	Taksa mbi firmën e biznesit	288,000.00	291,000.00	294,000.00
7	Administrata e përgjithshme	123,000.00	127,000.00	131,000.00
50013	Certifikatat e lindjes, vdekjes	68,000.00	70,000.00	71,000.00
50014	Certifikatat e kurorëzimit	35,000.00	36,000.00	37,000.00
50016	Certifikatat e tjera	20,000.00	21,000.00	23,000.00
0				
8	Drejtoria për B. e Financa	1,587.811.0 0	1,469.511.0 0	1,456,711.0 0
50408	Qiraja për lokalet e komunës	30,000.00	26,000.00	27,000.00
40110	Tatimi mbi pronën	1,377.811.0 0	1,273.511.0 0	1,249.711.0 0
50001	Taksa për regjistrimin e automjeteve	180,000.00	170,000.00	180,000.00
9	Drejtoria për Kulturë. Rini dhe sport	30,000.00	31,000.00	32,500.00
	Të hyrat nga kultura, rinia dhe sporti	30,000.00	31,000.00	32,500.00
	Dënimet në trafik-direkt nga MEF-i	130,000.00	131,000.00	132,000.00
	Te hyrat nga Gjykata	130,000.00	130,000.00	130,000.00
I	TOTALI I ADMINISTRATES KOMUNALE	2,825,311.0 0	2,769,911.0 0	2,820,911.0 0
II	ARSIMI	141,000.00	143,000.00	145,000.00
III	SHENDETËSIA	60,000.00	70,000.00	80,000.00
	SUB TOTALI (I + II + III)	3,026,311.0 0	2,977,911.0 0	3,035,911.0 0
IV	Participimet e qytetareve dhe të hyrat tjera etj.			
	SUB TOTALI (I + II + III+IV)	3,026,311.0 0	2,977,911.0 0	3,035,911.0 0

Për të pasur një pasqyrë mbi shpenzimet buxhetore të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike buxhetore, në tabelën vijuese të këtij KAB-i, po paraqesim trendët historike të shpenzimeve për periudhën e dy viteve të kaluara 2012, 2013, dhe buxhetin aktual 2014, me ç ‘rast mund të shihen shumat e mjeteve të shpenzuara buxhetore sipas destinimeve dhe pozicioneve buxhetore.

Tabela 4. - Trendi historik i financimit për Komunën e Gjakovës 2012-2014

Komuna e Gjakovës		2012 Aktual (Shpenzuar)	2013 Aktual (Shpenzuar)	2014 Aktual (Aprovuar)
1	Paga dhe mëditje	10,196,102.48	10,149,793.66	10,272,630.00
2	Mallëra dhe shërbime	1,708,009.66	1,522,268.73	1,572,972.00
3	Shpenzime komunale	649,065.18	650,300.31	733,185.00
4	Subvencione dhe transfere	1,069,566.32	457,649.00	526,000.00
5	Shpenzime kapitale	6,001,278.47	6,003,327.02	5,524,253.00
Totali :		19,624,022.11	18,783,338.72	18,629,040.00
	Numri i stafit	2.257	2.257	2.258

Konform Qarkores së parë buxhetore të lëshuar nga MF-ve nr.2015/01, të datës 15 Maj 2014, po paraqesim në këtë KAB, Propozimin e financimit të Komunës së Gjakovës sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për periudhën: 2015-2017.

Në këtë KAB- fillestar kemi paraqitur shpenzimin e pagave sipas gjendjes aktuale të muajit

Tabela 6. - Kufijtë e shpenzimeve të vlerësuara për financim për Komunën e Gjakovës 2015 - 2017


Komuna e Gjakovës		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	12,597,986.00	12,597,986.00	12,597,986.00
2	Mallëra dhe shërbime	1,541,300.00	1,576,000.00	1,618,000.00
3	Shpenzime komunale	684,600.00	682,700.00	710,800.00
4	Subvencione dhe transfere	600,000.00	597,000.00	709,000.00
5	Shpenzime kapitale	4,329,996.00	4,410,244.00	4,496,350.00
Totali :		19,753,882.00	19,863,930.00	20,132,136.00
	Numri i stafit	2.258	2.258	2.258

Propozim - Shpërndarja e Buxhetit komunal për periudhën 2015-2017, siç shihet edhe në tabelën e lartshënuar, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, është bërë konform limiteve buxhetore të përcaktuara me Qarkoren e parë buxhetore 2015/01, të dt.14.05.2014 të lëshuar nga ana e MF-ve për Komuna.

Struktura e Buxhetit Komunal për vitin 2015 duket si vijon:

- Paga dhe mëditje	12.597.986,00 €	(63,78 %)
- Mallra dhe shërbime.....	1.541.300,00 €	(7,81 %)
- Shpenzime komunale	684.600,00 €	(3,40 %)
- Subvencione	600.000,00 €	(3,02 %)
- Investime kapitale.....	4.329.996,00 €	(21,99%)

Totali: 19.753.882,00 €



Zyra e Kryetares

Deklarata e misionit: Zbatimi i të gjitha dispozitave ligjore dhe Rregulloreve që kane të bëjnë me qeverisjen komunale, zhvillimin ekonomik, dhe rritjen e mirëqenies të banorëve të Komunës së Gjakovës.

Deklarata e vizionit: Një Komunë të zhvilluar ekonomikisht, arsim, kulturë dhe shëndetësi të zhvilluar me standarde më të larta, bujqësi të avancuar, infrastrukturë moderne dhe mirëqenie njerëzore.

Deklarata e Qëllimit: zhvillim më të madh ekonomik , arritja e nivelit me të lartë të standardit të jetesës së banorëve të Komunës sonë.

Kufijtë e Shpenzimeve : 2015-2017

Zyra e Kryetarit		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	66,000.00	66,000.00	66,000.00
2	Mallra dhe shërbime	50,000.00	51,000.00	52,000.00
4	Subvencionet dhe transferet	50,000.00	55,000.00	60,000.00
	Kapitalet (Totali komunal)	-	-	-
	TOTALI	166,000.00	172,000.00	178,000.00
	Numri i stafit	7	7	7

Kryetarja
Mimoza Kusari Lila

Zyra e Kuvendit Komunal

Kufijtë e Shpenzimeve : 2015-2017

Asambleja komunale (Delegatët)		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	85,000.00	85,000.00	85,000.00
2	Mallra dhe shërbime	10,000.00	11,000.00	12,000.00
	TOTALI	95,000.00	96,000.00	97,000.00
	Numri i Delegatëve	35	35	35

Zyra e Kuvendit Komunal	2015	2016	2017
Kuantitative: Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit Komunal, në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale (nxjerrja e Rregulloreve ,Vendimeve, Udhëzimeve etj.) që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më të mirë të gjitha Drejtorive gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike te planit vjetor	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike te planit vjetor	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarik e te planit vjetor
Kualitative: 1. Kuvendi gjatë vitit kalendarik planifikon ti mbajë 12 mbledhje të obligueshme 2. KPF po ashtu 12 mbledhje të obligueshme	12 12 48	12 12 48	12 12 48

Kryesuesi
Luan Gola

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Deklarata e misionit:

Misioni i Drejtorit për Punë të Përgjithshme Administrative është të zbatoj të gjitha procedurat administrative të cilat janë me Ligj, Statut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, të ofrojë qasje transparente dhe shërbime efikase për të gjitha shërbimet Administrative Komunale; të ofroj konsulentë dhe bashkëpunim për të gjitha drejtoritë tjera dhe Kryetaren e Komunës, sigurimin e këshillave në zhvillim organizativ dhe për formulimin, autorizimin dhe zbatimin e menaxhimit dhe programet zhvillimore të stafit; Ofrimin e një shërbimi digjital dhe të shpejtë për të gjithë Qytetarët e Komunës së Gjakovës; përgjegjësitë dhe detyrat të cilat rrjedhin për çështjet e Integritetit Evropian; Bashkëpunim me të gjitha Ministrinë relevante për të ofruar qasje të drejtpërdrejt për të gjitha punët Administrative, gjithashtu dhe punë të tjera që kanë të bëjnë me çështjet Administrative të Përgjithshme që vijnë nga Kuvendi, Kryetarja apo Drejtoritë tjera.

Deklarata e Vizionit: Vizioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është që për periudhën 3 vjeçare, të rrisë efikasitetin e Shërbimeve Komunale, të shkurtoj kohën për kryerjen e shërbimeve, të digjitalizoj Shërbimet Administrative, të bashkojë gjitha Drejtoritë në një objekt Komunal, të ofroj transparencë në shërbimet Administrative dhe të rrisë shërbimet informative komunale për Qytetarët e Komunës së Gjakovës. Njëkohësisht ti përmbush obligimet e Drejtorisë që ka sipas statutit të Komunës dhe Ligjit në fuqi, si dhe në menaxhimin e stafit të shërbimit civil.

Deklarata e Qëllimit: Qëllimi i Drejtorisë është që të ofrojë një pasqyre transparente, rritje të efikasitetit të shërbimeve Komunale dhe të rrisë mirëqenën dhe efikasitetin e shërbyesve civil pranë Administratës Komunale. Përfitues Objektive dhe Vizionit të Drejtorisë, janë Qytetarët e Komunës së Gjakovës.

Kufijtë e Shpenzimeve : 2015-2017

Drejtoria e Administratës dhe Përsonelet		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	249,000.00	249,000.00	249,000.00
2	Mallra dhe shërbime	210,000.00	215,000.00	220,000.00
3	Komunalitë	45,000.00	50,000.00	53,000.00
5	Shpenzimet kapitale	130,000.00	-	-
	TOTALI	634,000.00	514,000.00	522,000.00
	Numri i stafit	56	56	56

Performanca	2015	2016	2017
Kuantitative			
1. Lëshon certifikata të gjendjes civile	45.000	50.000	55.000
2. Pranimi i kërkesave, ankesave parashtresave etj.	15.000	17.000	20.000
Kualitative			
1. Puna rreth certifikatave do të bëhet sipas programit Unik të Kosovës , ku do të kemi një përmirësim të kualitetit në shërbimet e karakterit civil.....	90%	95%	95%

Zyra e Prokurimit

Kufijtë e Shpenzimeve : 2015-2017

Zyra e Prokurimit		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	28,000.00	28,000.00	28,000.00
2	Mallra dhe shërbime	7,000.00	8,000.00	9,000.00
	TOTALI	35,000.00	36,000.00	37,000.00
	Numri i stafit	5	5	5

Drejtori
Armend Vokshi

Drejtoria për Inspeksionit

Deklarata e Misionit: Inspektimi i subjekteve ekonomike si dhe ndërmarrja e masave në harmoni ligjeve në fuqi, me qëllim të parandalimit të dukurive negative: mbrojtjen e shëndetit publik, mbrojtjen e ambientit, mbikëqyrjen e zbatueshme risë së Rregulloreve Komunale dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e konsumatorit etj. Harmonizimi me ligjet në fuqi duke i definuar qartë përgjegjësitë në harmoni të autorizimeve.

Deklarata e Vizionit: Drejtoria për Punë Inspektuese për periudhën e shënuar synon që ti zbatoj të gjitha procedurat, udhëzimet dhe politikat për implementimin sa më të mirë të aktiviteteve të kësaj drejtorie, të cilat do të bëhen konform udhëzimeve strategjike të Kryetares së Komunës, dhe njëkohësisht ti përmbush obligimet e Drejtorisë që ka sipas statutit të Komunës dhe Ligjeve në fuqi, si dhe të menaxhoj Inspektorët, dhe buxhetin dhe financat e kësaj drejtorie.

Deklarata e Qëllimit: Të kontribuojë në arritjen e politikave strategjive dhe objektivave të urdhëresave përmes inspektimeve efektive dhe efikase në lëmit përkatëse që i takojnë Drejtorisë për Punë Inspektuese.
Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve dhe perfeksionimin e një koordinimi me të madh të informimit, konsultave profesionale si dhe ide të aplikueshme me veprime dhe koncepte të qarta për të ardhmen e inspektorëve në vlerësimin objektiv të punës së tyre

Kufijtë e Shpenzimeve : 2015-2017

Drejtoria për Inspeksion		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	122.700,00	122.700,00	122.700,00
2	Mallra dhe shërbime	50.000,00	52.000,00	53.000,00
	TOTALI	172.700,00	174.700,00	175.700,00
	Numri i stafit	24	24	24

Performanca	2015	2016	2017
Kuantitative			
1. Do të përgatiten raportet mujore, 6 mujore dhe vjetore.....	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit
2. Do të shpërndahen, njoftime, kontrolle për sugjerime për të gjitha punët për ligjet e aplikueshme.....			
1.Detyra për raportet e punës, realizimi i inkasimit të taksave, dënimeve etj.	90%	90%	95%
2. Shpërndarja e vazhdueshme në realizimin e të hyrave.....	95%	96%	97%
3. Aksionet për inkasim të përbashkët me drejtoritë tjera.....	90%	90%	95%
4. Inkasomi i të hyrave për DPU dhe R.			

Drejtori
Mentor Sylmeta

Drejtoria për Buxhet e Financa

Deklarata e misionit: Bënë menaxhimin e buxhetit dhe financave të komunës, I siguron informatat për drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit , menaxhimin e shpenzimeve dhe informon liderët komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës.

Deklarata e vizionit: Përgatitja e materialeve për KPF dhe Kuvend, menaxhimin e financave komunale, përgatitjen e prezantimit të buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat.

Deklarata e Qëllimit: Menaxhimi me efikasitet të buxhetit komunal . përgatit buxhetin komunal për të gjitha Organizatat buxhetore brenda afateve kohore të përcaktuara nga MEF-i, rishikimet buxhetore, analizat, raportet etj.

Kufijtë e Shpenzimeve : 2015-2017

Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	154,000.00	154,000.00	154,000.00
2	Mallra dhe shërbime	40,000.00	42,000.00	43,000.00
5	Shpenzimet kapitale	205,000.00	-	-
	TOTALI	399,000.00	196,000.00	197,000.00
	Numri i stafit	32	32	32

Performanca	2015	2016	2017
Kuantitative			
1 Do të përgatiten raportet buxhetore-financiare mujore, tremujore dhe vjetore.	12	12	12
2. Do të shpërndahen faturat mbi ngarkesën e tatimit në pronë, identifikimi pronave të reja që do ndikojnë në rritjen e nr. Faktuarve.	27.000	27.500	28.000
3. Përpilimi dhe aprovimi i buxhetit vjetor dhe rishikimi për Organizatat buxhetore.			
Kualitative			
1. Të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë do shpenzohen në realizimin e projekteve kapital 2.Menagjimi me efikasitet i buxhetit dhe ekzekutimi i tij në mënyrë kualitative dhe sipas dinamikës së planifikuar të rrjedhjes së parasë së gatshme.	100 %	100 %	100 %

Drejtori
Teki Shala

Drejtoria e Shërbimeve publike

Deklarata e misionit: Misioni i Drejtorisë për Shërbime Publike është për të ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë efektive infrastrukturën dhe objektet publike, dhe ofron shërbime për publikun për të arritur dëshirat e përbashkëta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Drejtoria për Shërbime Publike merr një qasje pro aktivë drejt qëndrueshmërisë duke shndërruar metodat e transportit, konsumit të energjisë, menaxhim me mbeturina, planifikimin urban dhe arkitekturë të qëndrueshme për të ruajtur dhe për të përmirësuar qytetin për brezat e ardhshëm.

Deklarata e vizionit: Drejtoria e Shërbimeve Publike do të jetë një lider i njohur në ofrimin e shërbimeve publike; i njohur për reagimin tonë, seriozitetin, administrim të mirë të burimeve fiskale dhe njerëzore, dhe vëmendje kujdesshëm që i është dhënë popullatës.

Deklarata e Qëllimit: Për të mirëmbajtur, mbrojtur, dhe për të ruajtur, në kuadër të autoritetit të parashikuara në Ligjet e Kosovës si dhe Rregulloreve të Komunës, strukturat fizike dhe objektet të cilat janë përcaktuar të nevojshme për qëllime publike dhe për të ofruar shërbime për publikun për të lehtësuar arritjen e përbashkët sociale, ekonomike, dhe dëshirat mjedisore.

Kufijtë e Shpenzimeve : 2015-2017

Drejtoria për Shërbime Publike		2015 Vlerësuar	2016 Vlerësuar	2017 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	46,300.00	46,300.00	46,300.00
2	Mallra dhe shërbime	24,500.00	25,000.00	26,000.00
3	Komunalitë	190,000.00	192,000.00	193,000.00
	Subvencione-	5,000.00	7,000.00	8,000.00
5	Shpenzimet kapitale	1,196,385.00	1,341,000.00	1,476,300.00
	TOTALI	1,462,185.00	1,611,300.00	1,749,600.00

	2015	2016	2017
.Kuantitave:	Gjatë tërë vitit	Gjatë tërë vitit	Gjatë tërë vitit
1. Mirëmbajtja e ndriçimit publik,			
2. Menaxhim me mbeturina,			
3. Mirëmbajtja verore e rrugëve urbane dhe e shtratit të lumenjve të qytetit ,			
4. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane dhe rurale,			
5. Mirëmbajtja e gjelbërimit, parqeve dhe varrezave			

6. Mirëmbajtja e anësoreve të urave dhe aseteve tjera komunale			
